



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

101/8 Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

**PROGRAMET E ARSIMIT BAZË**

(Për klasat e shansit të dytë)

**LËNDA: GJEOGRAFI**

**KLASA VI-IX**

Tiranë

Dhjetor 2013

## **1. TË PËRGJITHSHME**

Lënda e gjeografisë në klasat 6 – 9 ka në fokusin e saj të studimit mjedisin gjeografik me karakteristikat e tij fizike dhe humane, marrëdhëniet e ndërsjella midis shoqërisë dhe komponentëve fizikë të Tokës, në kontekstin e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Themelore për lëndën e gjeografisë në arsimin e detyruar është puna për formimin e këndvështrimeve holistike për botën që na rrethon.

Në objektin e studimit të kësaj lënde, modelet dhe proceset e mjedisit fizik e human të rajoneve të veçanta të hapësirës shqiptare ose të botës në tërësi, shihen në lidhje të ndërsjellë.

Programi i gjeografisë synon zhvillimin e formimit gjeografik të nxënësve; kuptimin dhe vlerësimin e botës natyrore dhe humane të rajoneve dhe vendeve në botë; kuptimin dhe përdorimin e hartave, zhvillimin e aftësive hulumtuese dhe të zgjidhjes së problemit; formimin e vlerave dhe qëndrimeve për mbrojtjen e mjedisit të përbashkët.

Ky program ka për qëllim të zhvillojë të kuptuarit dhe vlerësimin e kushteve natyrore të rajoneve të ndryshme, karakteristikave shoqërore dhe ekonomike të tyre, por dhe të kushteve të ndryshme të jetesës së njerëzve në shkallë vendi, rajoni apo globi. Kështu nxënësi ndihmohet për të kuptuar më mirë kulturat e ndryshme, për të vlerësuar mënyrat e ndryshme të jetesës dhe për të respektuar diversitetin kulturor.

## **2. SYNIMET E LËNDËS**

Programi i lëndës së gjeografisë për klasat 6 - 9 synon arritjen e përfundimeve të përgjithshme të nxënësve, sipas të cilave nxënësit:

- zhvillojnë dijet për proceset e natyrës, të cilat, në kushte afatshkurtra dhe afatgjata, formojnë dhe ndryshojnë peizazhin natyror, si dhe kuptojnë si njeriu ndikon mbi këto procese, duke vlerësuar pasojat që rrjedhin prej tyre;
- kuptojnë dhe vlerësojnë kompleksitetin natyror e human të rajoneve e nënrajoneve të ndryshme të botës;
- zhvillojnë, përmes studimit të gjeografisë kombëtare, aftësitë qytetare të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre si individë, në përgatitjen e tyre për jetën, punën dhe shoqërinë;
- rritin shkallën e përgjegjësisë për kujdesin ndaj mjedisit, përmes zhvillimit të aftësive vendimmarrëse rreth çështjeve që lidhen me shoqërinë dhe mjedisin;

- vlerësojnë lidhjet dhe marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe mjedisore ndërmjet trevave shqiptare dhe vendeve ku ato ndodhen, me Bashkimin Evropian dhe vende të tjera të botës;
- zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të realizuar kërkimin gjeografik dhe punën me hartën;
- demonstrojnë qëndrime e sjellje etiko-sociale në punë individuale e në grup.

### **3. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT**

Përdorimi i metodave dhe teknikave të ndryshme lehtëson zbatimin efektiv të programit të gjeografisë. Metodatat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies janë ndër faktorët më kryesorë për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin e nxënësve, të nxënësve të pavarur, të menduarin kritik e krijues, punën në grup etj.

Metodat, teknikat, strategjitë e zgjedhura nga mësuesi duhet të përshtaten me stile të ndryshme të nxënësve. Ato duhet:

- t'u lejojnë nxënësve kënaqësinë e zbulimit vetë, të gjërave;
- të aftësojnë nxënësit të punojnë për problemet e tyre sa më gjatë që të jetë e mundur;
- të nxitin nxënësit të bëjnë vetë pyetje;
- të përdorin idetë e nxënësve si bazë për veprimtaritë që do të kryhen.

Përzgjedhja e metodave që mësuesi përdor varet nga përmbajtja e temës mësimore, nga objektivat mësimore, shkalla e njohurive që zotërojnë nxënësit, vendi ku do të zhvillohet mësimi, mjetet mësimore që zotëron mësuesi etj.

Gjatë procesit të mësimdhënies së kësaj lënde, mësuesi duhet t'i kushtojë vëmendje metodave dhe teknikave ndërvepruese që çojnë në realizimin e veprimtarive, si: diskutimi, stuhia e mendimeve, puna në grupe të vogla, udhëtimet imagjinare, projekti mësimor etj.

Metodat që përdor mësuesi, nuk mund të jenë me rendimentin e duhur pa mbështetjen e mjeteve didaktike, ku vendin kryesor e zënë hartat e llojeve e shkallëve të ndryshme, atlase, globe, skica, grafikë etj.

Materiale me vlerë mund të gjenden në burime historike, gjeografike apo me karakter shoqëror, si dhe në tregime e lloje të tjera burimesh. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të mësojnë duke bërë pyetje, duke kryer vëzhgime sistematike e duke grumbulluar të dhëna. Një ndër synimet e lëndës

së gjeografisë është të zhvillojë aftësinë e nxënësve për të lexuar, për të interpretuar dhe për të përdorur hartat. Nxënësit duhet të aftësohen në përdorimin e tabelave dhe të grafikëve.

### **Integrimi lëndor**

Lënda e gjeografisë zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera, duke ndihmuar në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

Gjeografia mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë objektivat e saj. Por dhe lëndët e tjera mund të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e gjeografisë për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Me lëndën *eedukimit qytetar* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me mjedisin, me marrëdhënien njeri-mjedis, marrëdhënien ndërshtetërore, globalizimin etj.

Me lëndën e *historisë* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartat historike, marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve në nivel vendor, kombëtar e global, zhvillimet historike të popullit shqiptar etj.

Me lëndën e *matematikës* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me përdorimin e numrave, masave, gjatësisë dhe kohës, interpretimin e të dhënave, ndërtimin e grafikëve, përdorimin e simboleve dhe tabelave për prezantimin e informacionit.

Me *shkencat e natyrës* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me koncepte dhe dukuri të ndryshme natyrore, si p.sh. nxënësit përdorin konceptet bazë të kimisë kur studiojnë shkëmbinj të dhe mineralet; konceptet e fizikës kur studiojnë lëvizjet e Tokës; të biologjisë kur studiojnë historinë e Tokës dhe mjedisin.

Me lëndën e *gjuhës shqipe* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartimin e eseve, gjetjen dhe shfrytëzimin e materialeve mediatike, të shkruarin, të lexuarin dhe komunikimin e informacioneve të gjeografisë.

Aspektet kros-kurrikulare janë patur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- atdhedashurisë;
- kulturës së komunikimit;
- mjeteve të informimit si media, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- globalizmit.

#### **4. VLERËSIMI**

Realizimi i përshkallëzuar i programit kërkon zgjedhjen e formave dhe teknikave të vlerësimit të përshtatshme për të kontrolluar shkallën e përvetësimit të dijeve të nxënësve. Përsosja e këtyre teknikave çon në verifikimin më objektiv të përgatitjes, ndjekjen hap pas hapi të ecurisë së përparimit të nxënësve, shtimin e kontrolleve përmes ndërtimit të testeve, zgjidhjeve të detyrave, ushtrimeve, punës me hartën, punëve praktike etj.

Vlerësimi i nxënësve mund të jetë përmbledhës ose formativ, i planifikuar që në fillim të vitit ose i rastësishëm, në varësi të programit mësimor dhe të problemeve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi mund të jetë gojor, me shkrim ose i ndërthurur. Përvoja praktike është mënyra më e mirë për të vlerësuar aftësitë shkencore dhe teknike.

Mbajtja e shënimeve për gabimet tipike të nxënësve dhe mangësitë me karakter të ndryshëm që ata kanë për njohuri e shprehje të veçanta, do ta ndihmonte mësuesin në planifikimin më të mirë të veprimtarive didaktike të ardhshme.

Kujdes i veçantë të tregohet në korrigjimin dhe vlerësimin e detyrave të nxënësve, sidomos të punimeve që plotësohen hap pas hapi gjatë veprimtarive të pavarura sikurse janë punët praktike. Në këto raste mësuesi duhet të shënojë me hollësi natyrën e gabimeve të mundshme të shoqëruara këto me sqarimet përkatëse, por edhe të demonstrojë punimet më të mira, duke i komentuar ato.

Më poshtë listohen disa teknika vlerësimi që mund të përdoren për vlerësimin e nxënësve. Lista shërben vetëm si referencë, pasi është mësuesi ai që duhet të përzgjedhë teknikën e përshtatshme sipas qëllimit të vlerësimit.

Metodat e organizimit të vlerësimit në këtë lëndë mund të jenë:

- vlerësimi individual (i një nxënësi me gojë ose me shkrim);
- vlerësimi në grup (grupi me nga 3-4 nxënës, më shumë ose më pak, kur nxënësi/ja realizon një projekt ose detyrë kërkimore);
- vlerësimi i një detyre për të cilën është arritur një marrëveshje midis mësuesit/es dhe nxënësve (p.sh. nëse plotëson pa gabime hartën skicë të Evropës, vlerësohesh me notë maksimale);
- vlerësimi në çift ose vetëvlerësimi (p.sh. shoku vlerëson detyrën ose përgjigjen e shokut dhe anasjelltas, ose nxënësi vlerëson veten për realizimin e detyrës, përgjigjes ose testit);
- vlerësimi i portofolit (dosjes) të nxënësit (i një grupi detyrash të pavarura, të kryera dhe të mbajtura shënim nga ai).

Ndjekja në vazhdimësi e nxënësit :

- Detyra me shkrim
- Përgjigje me gojë
- Detyra kontrolli
- Detyra shtëpie
- Punë praktike

Pyetjet e mira kanë rëndësi të veçantë për mësimdhënien dhe vlerësimin efektiv. Vlerësimi nuk mund të mbështetet totalisht në atë me shkrim, pasi nxënësit kanë stile të ndryshme të të nxënit.

## **5. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi është ndërtuar duke u bazuar në qëllimin, synimet, parimet dhe kriteret e kurrikulës si dhe te standardet e arritjes së gjeografisë.

Në programin sintetik përcaktohet shpërndarja e orëve sipas tematikave të mëdha (kapitujve), ndërsa mësuesit janë të lirë të planifikojnë shpërndarjen e orëve për temat e veçanta brenda një kapitulli.

## PROGRAMI I GJEOGRAFISË SIPAS KLASAVE

### KLASA 6

**30 javë x 1 orë /javë = 30 orë mësimore vjetore**

Programi i gjeografisë për klasën e 6-të, “Gjeografia fizike” do të zhvillohet me 1 orë mësimore në javë, përgjatë 30 javëve mësimore vjetore.

#### PROGRAMI SINTETIK

- Njohuri të reja **26 orë**
- Punë praktike **2 orë**
- Përsëritje **2 orë**

#### SHPËRNDARJA E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE

Nr.	Tematikat kryesore të përmbajtjes	Numri i orëve
I.	Konceptet bazë të kërkimit gjeografik	8 orë njohuri të reja, 1 orë punë praktike
II.	Modelet në gjeografinë fizike	15 orë njohuri të reja, 1 orë punë praktike
III.	Resurset natyrore	3 orë njohuri të reja

#### PROGRAMI ANALITIK

##### **I. Konceptet bazë të kërkimit gjeografik**

Në përfundim të klasës së gjashtë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të identifikojnë konceptet që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: lokalizimi/ vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi dhe zhvillimi;
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit vend/lokalizim (p.sh. një vend përcaktohet nga karakteristikat e përbashkëta fizike dhe humane, ndërsa me lokalizim kuptojmë ku ndodhet një vend dhe çfarë lidhjesh relative ka ai me vendet e tjera);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për mjedisin (p.sh. në sistemin e elementeve jetësore dhe jojetësore, njerëzit janë pjesë e elementeve jetësore);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për rajonin (p.sh. rajoni është një pjesë e sipërfaqes së tokës që ka karakteristika të njëjta ose të ngjashme);

- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për ndërveprimin (p.sh. njerëzit e ndryshojnë mjedisin duke e përdorur atë etj.);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për zhvillimin (qarkullimin, lëvizjen), (p.sh. qarkullimi i njerëzve, mallrave dhe informacioneve, si dhe faktorët që ndikojnë në këtë qarkullim etj.);
- të përdorin fjalorin e mësuar (p.sh. dukuri, vendndodhje absolute, vendndodhje relative, ndërveprim, rajon) për të përshkruar kërkimet dhe vëzhgimet e tyre;
- të formulojnë pyetje të tipave të ndryshëm për të identifikuar çështjet dhe për të përcaktuar problemet dhe drejtimet e kërkimeve gjeografike;
- të zbulojnë informacionet kryesore nga llojet e shumta të burimeve (p.sh. fotografitë ajrore, hartat, diagramet, ilustrimet, materialet e printuara etj.);
- të ndërtojnë grafikë, diagrame për qëllime të ndryshme mësimore;
- të paraqesin, sipas këndvështrimeve të ndryshme, përfundimet e kërkimeve të tyre për një çështje të caktuar duke përdorur mjetet e medias, paraqitjet gojore, materialet e shkruara, tabela, harta, grafikë etj.

## **II. Modelet në gjeografinë fizike**

Në përfundim të klasës së gjashtë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të identifikojnë modelin si një koncept të rëndësishëm të gjeografisë (p.sh. lokalizimi i vullkaneve përgjatë bregut të oqeanit Paqësor);
- të shpjegojnë si dhe sa përdoren format e tokës për të përshkruar rajonet;
- të përshkruajnë modelet botërore të formave të tokës (p.sh. vendndodhjen e vargjeve malore gjatë brigjeve perëndimore të Amerikës së Veriut dhe të Jugut etj.);
- të përshkruajnë modelet klimatike të botës;
- të demonstrojnë të kuptuarit e arsyeve që modelet e klimës rrjedhin nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm: gjerësia gjeografike, lartësia mbi nivelin e detit, sistemi botëror i erërave, masat ajrore, largësia nga deti, rrymat oqeanike etj.;
- të identifikojnë pasojat e dukurive natyrore (p.sh. tornadot, vullkanet, tërmetet, tajfunet) për njerëzit dhe mjedisin;



- të demonstrojnë të kuptuarit e arsyeve që modelet e vegjetacionit natyror rrjedhin nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm: temperatura, reshjet, tipat e dherave, mundësitë e të ushqyerit etj.;
- të identifikojnë sistemet e mëdha lumore të botës (p.sh. Amazona, Nili etj.);
- të përdorin fjalorin e mësuar, përfshirë këtu terminologjinë e saktë gjeografike (p.sh. model, gjerësi, lartësi etj.) për të përshkruar kërkimet dhe vëzhgimet e tyre;
- të zbulojnë nga llojet e shumta të burimeve gjeografike, informacionet kryesore në lidhje me modelet fizike;
- të ndërtojnë grafikë, diagrame për të organizuar informacionet (p.sh. në lidhje me shpërndarjen e reshjeve etj.);
- të identifikojnë modelet në gjeografinë fizike duke përdorur hartat tematike.

### **III. Resurset natyrore**

Në përfundim të klasës së gjashtë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të identifikojnë modelet që ekzistojnë në shpërndarjen dhe përdorimin e resurseve natyrore në të gjithë botën;
- të demonstrojnë të kuptuarit e rolit dhe të ndikimit të teknologjisë në drejtim të resurseve natyrore (p.sh. në lidhje me zbulimin, nxjerrjen, përpunimin dhe shitblerjen);
- të demonstrojnë kuptimin e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm dhe veprimin e tij në mjedis;
- të paraqesin dhe të mbrojnë sipas këndvështrimit të tyre mënyrën e përdorimit të një burimi natyror;
- të përdorin saktë fjalorin dhe terminologjinë gjeografike të mësuar (p.sh. resurs, zhvillimi i qëndrueshëm etj.) për të përshkruar kërkimet dhe vëzhgimet e tyre;
- të vlerësojnë të dhënat (p.sh. në lidhje me modelet e shpërndarjes dhe të përdorimit të resurseve natyrore etj.);
- të ndërtojnë grafikë, diagrame dhe modele të ndryshme për të organizuar informacionet;
- të paraqesin përfundimet e kërkimeve dhe të vëzhgimeve të tyre duke përdorur raportimet gojore ose të shkruara, vizatimet, tabelat me të dhëna statistikore, diagramet etj.;
- të tregojnë në hartë vendndodhjen e resurseve natyrore të Shqipërisë.

## KLASA 7

**30 javë x 1 orë /javë = 30 orë mësimore vjetore**

Programi i gjeografisë për klasën e 7-të, “Gjeografia e Evropës” do të zhvillohet me 1 orë mësimore në javë, përgjatë 30 javëve mësimore vjetore.

### **PROGRAMI SINTETIK**

- Njohuri të reja **25 orë**
- Punë praktike **2 orë**
- Përsëritje **3 orë**

### **SHPËRNDARJA E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE**

<b>Nr.</b>	<b>Tematikat kryesore të përmbajtjes</b>	<b>Numri i orëve</b>	
I.	Natyra dhe popullsia	5 orë njohuri të reja	1 orë punë praktike
II.	Gjeografia politike dhe ekonomike	4 orë njohuri të reja	
III.	Evropa perëndimore e veriore	5 orë njohuri të reja	
IV.	Evropa qendrore	3 orë njohuri të reja	
V.	Evropa lindore	2 orë njohuri të reja	
VI.	Evropa jugore	1 orë njohuri të reja	
VII.	Ballkani	5 orë njohuri të reja, 1 orë punë praktike	

### **PROGRAMI ANALITIK**

#### **I. Natyra dhe popullsia**

- Identiteti kulturor dhe historik i Evropës
- Veçoritë e relievit dhe të hidrografisë
- Klima dhe mjediset jetësore. Zona mesdhetare
- Veçoritë e përgjithshme gjeografike të popullsisë
- Gjuhët dhe besimet
- Lëvizjet migratore

#### **II. Gjeografia politike dhe ekonomike**

- Bashkimi Evropian – etapat e integritimit
- Vendet e BE-së

- Organizmat politike të BE- së
- Problemet ekonomike e politike
- *Punë praktike: Harta e veçorive natyrore, veçorive të popullsisë dhe ekonomisë të Evropës.*

### **III. Evropa perëndimore e veriore**

- Vështrim i përgjithshëm
- Popullsia dhe harta politike
- Ekonomia dhe transporti
- Franca dhe Monako
- Vendet e Beneluksit. Belgjika
- Holanda dhe Luksenburgu
- Gjermania
- Vendet alpine. Zvicra, Austria dhe Lihtenshtejni
- Mbretëria e Bashkuar
- Irlanda
- Vendet Skandinave. Danimarka e Islanda
- Norvegjia, Suedia e Finlanda

### **IV. Evropa qendrore**

- Vështrim i përgjithshëm
- Vendet Baltike. Lituania, Letonia e Estonia
- Polonia e Hungaria
- Çekia e Sllovakia

### **V. Evropa lindore**

- Vështrim i përgjithshëm
- Rusia
- Ukraina
- Bjellorusia
- Moldavia

## **VI. Evropa jugore**

- Italia e Vatikani
- Vendet iberike. Spanja, Portugalia e Andora

## **VII. Ballkani**

- Vështrim i përgjithshëm
- Kosova
- Sllovenia
- Kroacia
- Bosnja dhe Hercegovina
- Serbia
- Mali i Zi
- Maqedonia
- Greqia
- Bullgaria
- Rumania
- *Punë praktike: Harta e veçorive natyrore, politike dhe ekonomike të Ballkanit.*

### **KLASA 8**

**30 javë x 1 orë / javë = 30 orë mësimore vjetore**

Programi i gjeografisë për klasën e 8-të, “Gjeografia e Botës” do të zhvillohet me 1 orë mësimore në javë, përgjatë 30 javëve mësimore vjetore.

#### **PROGRAMI SINTETIK**

- Njohuri të reja **25 orë**
- Punë praktike **3 orë**
- Përsëritje **2 orë**

#### **SHPËRNDARJA E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE**

<b>Nr.</b>	<b>Tematikat kryesore të përmbajtjes</b>	<b>Numri i orëve</b>	
I.	Popullsia dhe urbanizimi në botë	3 orë njohuri të reja	
II.	Njeriu dhe burimet (resurset)	1 orë njohuri të reja	
III.	Sistemet politike dhe ekonomike	2 orë njohuri të reja	
IV.	Amerikat	7 orë njohuri të reja, 1 orë punë praktike	
V.	Afrika	4 orë njohuri të reja, 1 orë punë praktike	
VI.	Azia	6 orë njohuri të reja	1 orëpunë praktike
VII.	Oqëania dhe tokat polare	2 orë njohuri të reja	

## **PROGRAMI ANALITIK**

### **I. Popullsia dhe urbanizimi në botë**

- Popullimi i planetit tonë
- Lëvizjet migratore
- Gjuhët dhe besimet fetare
- Sistemet urbane. Qytetet në vendet e zhvilluara
- Qytetet në vendet në zhvillim

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të identifikojnë shkaqet e rritjes dhe shpërndarjes së pabarabartë të popullsisë së planetit tonë;
- të interpretojnë lëvizjet natyrore dhe hapësinore të popullsisë, strukturën e popullsisë sipas rajoneve dhe vendbanimeve;
- të analizojnë prirjet e kohës lidhur me urbanizimin dhe industrializimin;
- të identifikojnë tiparet dhe veçoritë e gjuhëve dhe besimeve fetare në planetin tonë.

### **II. Njeriu dhe burimet (resurset)**

- Resurset e planetit dhe dobia e tyre
- Resurset e papërtërishme dhe shfrytëzimi industrial i tyre
- Resurset e përtërishme (pasuritë e klimës, relievit, hidrografisë, tokave etj.)
- Popullsia dhe burimet. Planeti në rrezik

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të evidentojnë se resurset natyrore bëjnë të mundur ekzistencën dhe zhvillimin e shoqërisë.
- të dallojnë resurset e ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme;
- të shpjegojnë modelet e sotme të ruajtjes së baraspeshave në trinomin: mjedis natyror-popullsi-zhvillim ekonomik;
- të identifikojnë shkaqet e degradimit dhe të ndotjes së mjedisit, si dhe modelet e përparuara për rregullimin dhe organizimin hapësinor të vendbanimeve dhe objekteve ekonomike.

### **III. Sistemet politike dhe ekonomike**

- Ndarja shoqërore e punës.
- Globalizimi i ekonomisë dhe i kulturës
- Vendet e pasura dhe vendet e varfra.
- Tipologjia e shteteve dhe organizatat ndërkombëtare.

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të evidentojnë tiparet dhe veçoritë e organizimit politik, strukturor dhe të shpërndarjes hapësinore të ekonomisë në kontinente, rajone dhe shtete të veçanta;
- të shqyrtojnë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet vendeve dhe ndikimin që kanë ngjarjet ose veprimet që ndodhin në rajone të ndryshme të vendit ose të botës me njëra-tjetrën;
- të shpjegojnë rolin e organizmave në ngjarje të caktuara dhe mënyrat si ato ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në botë;
- të shpjegojnë rëndësinë e bashkëpunimit të Shqipërisë me secilin prej këtyre organizmave, parë ky bashkëpunim në planin ekonomik, kulturor, social, politik etj.;
- të tregojnë rrugët e bashkëpunimit ndërkombëtar në të mirë të parandalimit të problemeve të ndryshme globale.

### **IV. Amerikat**

- Karakteristikat e përgjithshme gjeografike

- Popullsia dhe vendbanimet
- Veprimtaritë ekonomike
- Amerika Anglosaksone.
- ShBA (natyra dhe popullsia)
- ShBA (vështrim ekonomik dhe politik)
- Kanadaja-Vendi i territoreve të mëdha.
- Amerika Latine.
- Meksika dhe Amerika Qendrore
- Amerika Qendrore Ishullore, Kuba.
- Amerika ndërtropikale, Venezuela dhe Kolumbia.
- Brazili
- Rajoni i Andeve, Kili dhe Peruja.
- Rajoni i Pampës, Argjentina.
- *Punë praktike: Harta e veçorive natyrore, politike dhe ekonomike të Amerikës veriore dhe jugore*

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë tiparet dhe veçoritë gjeografike të kontinenteve të Amerikës së Veriut dhe Amerikës së Jugut., rajoneve e shteteve të këtyre kontinenteve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit në botë;
- të shpjegojnë rolin e faktorëve kryesorë natyrorë që kanë përcaktuar larminë e theksuar të ndërtimit gjeologjik, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave, mbulesës bimore e botës shtazore dhe të komplekseve fiziko-gjeografike të Amerikës së Veriut dhe Amerikës së Jugut;
- të përshkruajnë veçoritë e organizimit politik, strukturor dhe të shpërndarjes hapësinore të ekonomisë në Amerikën e Veriut dhe Amerikën e Jugut, rajone dhe shtete të veçanta të këtyre kontinenteve;
- të përdorin të dhënat e ndryshme që marrin nga mjetet e informacionit masiv, për të demonstruar dhe për të kuptuar më mirë dukuritë dhe proceset gjeografike;

- të përdorin shprehitë praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë etj.

## **V. Afrika**

- Karakteristikat e përgjithshme gjeografike
- Popullsia dhe veprimtaritë ekonomike
- Rajoni i Afrikës Mesdhetare
- Afrika Sudaneze, (SAHELI-Mauritania, Mali, Nigeri, Çadi, Sudani)
- Afrika Perëndimore, Guinea, Nigeria
- Afrika Qendrore Ekuatoriale, R.D.Kongos
- Afrika Lindore, Kenia dhe Tanzania
- Afrika Jugore, Republika Jug-afrikane
- *Punë praktike: Harta e veçorive natyrore, politike dhe ekonomike të Afrikës*

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë pozitën gjeografike dhe veçoritë gjeografike të kontinentit të Afrikës, rajoneve e shteteve të këtij kontinenti;
- të shpjegojnë rolin e faktorëve kryesorë natyrorë që kanë përcaktuar larminë e theksuar të ndërtimit gjeologjik, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave, mbulesës bimore e botës shtazore dhe të komplekseve fiziko-gjeografike të Afrikës;
- të përshkruajnë tiparet dhe veçoritë e organizimit politik, strukturor dhe të shpërndarjes hapësinore të ekonomisë në Afrikë, rajone dhe shtete të veçanta të këtij kontinenti;
- të përdorin shprehitë praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë etj.

## **VI. Azia**

- Karakteristikat e përgjithshme gjeografike
- Popullsia dhe veprimtaritë ekonomike
- Mesdheu aziatik, Turqia, Izraeli, Palestina etj.



- Lindja e Mesme, Arabia Saudite, Irani, Iraku etj.
- Republikat e Kaukazit dhe Azisë Qendrore
- Subkontinenti indian, India Pakistani etj.
- Azia Juglindore (vështrim i përgjithshëm)
- Indonezia dhe Filipinet
- Lindja e Largët (vështrim i përgjithshëm)
- Kina
- Japonia
- Gadishulli i Koresë

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë pozitën gjeografike dhe veçoritë gjeografike të kontinentit të Azisë, rajoneve e shteteve të këtij kontinenti;
- të shpjegojnë rolin e faktorëve kryesorë natyrorë që kanë përcaktuar larminë e theksuar të ndërtimit gjeologjik, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave, mbulesës bimore e botës shtazore dhe të komplekseve fiziko-gjeografike të Azisë;
- të përshkruajnë tiparet dhe veçoritë e organizimit politik, strukturor dhe të shpërndarjes hapësimore të ekonomisë në Azi, rajone dhe shtete të veçanta të këtij kontinenti;
- të përdorin shprehjet praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë etj.

## **VII. Oqeania dhe tokat polare**

- Karakteristikat e përgjithshme gjeografike
- Popullsia dhe veprimtaritë ekonomike
- Australia
- Zelanda e Re dhe Guinea Papua
- Melanezia, Mikronezia dhe Polinezia
- Antarktida dhe Arktiku

- *Punë praktike: Harta e veçorive natyrore, politike dhe ekonomike të Azisë, Oqeanisë dhe tokave polare.*

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë pozitën gjeografike dhe veçoritë gjeografike të Oqeanisë dhe tokave polare;
- të shpjegojnë rolin e faktorëve kryesorë natyrorë që kanë përcaktuar larminë e theksuar të ndërtimit gjeologjik, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave, mbulesës bimore e botës shtazore dhe të komplekseve fiziko-gjeografike të Oqeanisë dhe tokave polare;
- të përshkruajnë tiparet dhe veçoritë e organizimit politik, strukturor dhe të shpërndarjes hapësinore të ekonomisë në Oqeani dhe shtete të veçanta të këtij rajoni;
- të përdorin shprehitë praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë etj.

### **KLASA 9**

**30 javë x 1 orë /javë = 30 orë mësimore vjetore**

Programi i gjeografisë për klasën e 9-të, “Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare” do të zhvillohet me 1 orë mësimore nëjavë, përgjatë 30 javëve mësimore vjetore.

#### **PROGRAMI SINTETIK**

- Njohuri të reja **25 orë**
- Punë praktike **3 orë**
- Përsëritje **2 orë**

#### **SHPËRNDARJA E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE**

<b>Nr.</b>	<b>Tematikat kryesore të përmbajtjes</b>	<b>Numri i orëve</b>	
I.	Pozita gjeografike, përbërja e trevave shqiptare dhe harta politike e tyre	2 orë njohuri të reja	1 orë punë praktike
II.	Natyra e trevave shqiptare	2 orë njohuri të reja	
III.	Popullimi i trevave shqiptare	1 orë njohuri të reja	
IV.	Ekonomia e trevave shqiptare	2 orë njohuri të reja	
V.	Probleme mjedisore të trevave shqiptare	1 orë njohuri të reja	
VI.	Rajonet gjeografike të Shqipërisë dhe	12 orë njohuri të reja, 2 orë punë praktike	

	veçoritë e tyre	
VII.	Trevat shqiptare përtej kufirit të Republikës së Shqipërisë	5 orë njohuri të reja

## **PROGRAMI ANALITIK**

### **I. Pozita gjeografike dhe harta politike e trevave shqiptare**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, në Evropë dhe në Mesdhe;
- të interpretojnë rolin e kësaj pozite në dukuritë natyrore, popullimin dhe zhvillimin social – ekonomik të tyre;
- të përshkruajnë proceset historike, politike dhe gjeografike që përcaktuan ndryshimet dhe formimin e hartës politike të trevave shqiptare, shkaqet e copëtimit të tyre në disa shtete ballkanike; statusi i sotëm politik dhe e ardhmja e tyre në familjen e madhe evropiane;
- të dallojnë përbërjen e trevave shqiptare, vendosjen e tyre sipas shteteve në hartën politike të Evropës Juglindore.

### **II. Natyra e trevave shqiptare**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të vlerësojnë rolin e pozitës gjeologjike, të formimit dhe përbërjes së truallit të trevave shqiptare në larminë dhe shumëllojshmërinë e pasurive minerare të tyre; mundësitë që ofrojnë këto pasuri në zhvillimin e tyre;
- të shpjegojnë veçoritë kryesore dhe larminë e formave të relievit të trevave shqiptare, shtrirjen e elementëve kryesorë të këtij relievi, rolin e tyre në dukuritë natyrore, në popullimin dhe në zhvillimin ekonomik;
- të identifikojnë në hartën fizike të trevave shqiptare, vendosjen e elementëve kryesorë të relievit të tyre;
- të shpjegojnë veprimin e faktorëve të formimit të klimës, veçoritë kryesore dhe larminë e saj në trevat shqiptare, tiparet e elementëve kryesorë klimatikë;

- të ndërtojnë dhe interpretojnë grafikët e regjimit të elementëve kryesorë klimatikë;
- të interpretojnë rolin e faktorëve dhe kushteve të formimit të hidrografisë së trevave shqiptare;
- të lexojnë hartën e rrjetit hidrografik të trevave shqiptare;
- të vlerësojnë pasuritë ujore dhe potencialet turistike të brigjeve detare dhe liqenore, mënyrën e shfrytëzimit të tyre për qëllime ekonomike dhe turistike;
- të shpjegojnë konceptin toka pjellore dhe të varfra, faktorët dhe shkaqet e dëmtimit, degradimit dhe ndotjes së tokave, rrugët e mbrojtjes së tyre;
- të shpjegojnë shkaqet e larmisë së bimësisë dhe të botës shtazore të trevave shqiptare; përbërjen e saj sipas kateve bimore, llojet e kafshëve të egra; shkallën e dëmtimit dhe degradimit të mbulesës bimore dhe rrugët e mbrojtjes dhe ripërtëritjes së saj.

### **III. Popullimi i trevave shqiptare**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë organizimin administrativ të territorit të trevave shqiptare, faktorët dhe ndryshimet gjatë historisë së skemës së organizimit të territorit të trevave shqiptare;
- të shpjegojnë faktorët dhe kushtet e popullimit të hershëm të trevave shqiptare, faktorët dhe treguesitë rritjes së numrit të popullsisë; të shpërndarjes gjeografike dhe ndryshimeve të treguesve të shtimit natyror dhe të dendësisë së popullsisë, të strukturës moshore dhe gjinore, kombëtare dhe fetare të popullsisë;
- të shpjegojnë faktorët dhe pasojat e migrimeve të popullsisë së popullsisë shqiptare sipas trevave;
- të shpjegojnë dukuritë e vendbanimeve rurale dhe urbane, shkaqet e ndryshimeve të strukturës dhe të arkitekturës të ndërtesave si dhe të problemeve mjedisore të tyre;
- të ndërtojnë dhe të analizojnë grafikët e strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj.

### **IV. Ekonomia e trevave shqiptare**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të shpjegojnë premisat, resurset natyrore dhe humane për zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare; rolin e faktorëve historikë dhe politikë në zhvillimin e tyre ekonomik;
- të interpretojnë strukturën ekonomike të trevave shqiptare (industrinë, bujqësinë, sektorin terciar);
- të ndërtojnë dhe të analizojnë grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore dhe industriale të trevave shqiptare.

## **V. Probleme mjedisore të trevave shqiptare**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të evidentojnë dhe të vlerësojnë pasuritë e mjedisit të trevave shqiptare, të diferencuara në të përtëritshme dhe të papërtëritshme, në të përgjithshme dhe të veçanta, unikale;
- të vlerësojnë rolin dhe vendin e pasurive mjedisore në shkallën e zhvillimit të trevave shqiptare;
- të vlerësojnë shkaqet e problemeve të sotme mjedisore, si: ndotjen e ajrit, ujit, dhe të tokës, dëmtimin e biodiversitetit, të sipërfaqeve të gjelbra dhe të faunës, degradimin dhe shkretërizmin e tokës dhe të peizazheve nga erozioni, dhe rrugët e mbrojtjes së mjedisit dhe të zgjidhjes së problemeve të sotme tepër të mprehta mjedisore etj.;
- të vlerësojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të trevave shqiptare, zhvillimin e turizmit, kategoritë e zonave të mbrojtura.

## **VI. Përbërja e trevave shqiptare, rajonet gjeografike dhe veçoritë e tyre**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë të gjitha trevat shqiptare, përbërjen, shtrirjen, kufijtë, pozitën gjeografike të tyre në raport me polet urbane dhe akset kryesore të transportit;
- të vlerësojnë pozitën gjeografike të Shqipërisë në dukuritë fiziko-gjeografike, në popullimin dhe zhvillimin social – ekonomik; vlerat e veçanta të pozitës tranzit të vendit tonë midis lindjes dhe perëndimit;

- të shpjegojnë tiparet e përgjithshme të natyrës, popullsisë, ekonomisë të Shqipërisë, faktorët e zhvillimit, shkaqet e gjendjes aktuale, ndryshimet gjatë etapave të ndryshme, problemet aktuale, perspektivat e zhvillimit në të ardhmen në kuadrin kombëtar, rajonal dhe më gjerë;
- të shpjegojnë shkaqet dhe faktorët e diferencimit rajonal të hapësirës gjeografike të Shqipërisë dhe tiparet kryesore të rajoneve të saj gjeografike;
- të shpjegojnë rolin e pozitës gjeografike në veçoritë natyrore dhe sociale ekonomike të **Rajonit Verior dhe Verilindor të Shqipërisë**; shkaqet e diferencimit të tij në nënrajonë;
- të shpjegojnë shkaqet e larmisë së theksuar të natyrës së Alpeve Shqiptare; ofertat dhe resurset natyrore të tyre për popullim;
- të evidentojnë gjurmët e popullimit të hershëm të Alpeve shqiptare, veçoritë e këtij popullimi, ndikimin e fuqishëm të faktorëve natyrorë në popullimin e pakët të tyre, shkaqet e izolimit dhe të traditave të pasura materialo-shpirtërore; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë së tyre drejt rajoneve fushore të vendit;
- të vlerësojnë kushte e vështira për zhvillim e bujqësisë në Alpet, strukturën ekonomike si nënrajon blegtoral dhe bujqësor; potenciale të mëdha për zhvillimin e disa llojeve të turizmit, të pylltarisë dhe të blegtorisë;
- të evidentojnë përparësitë e pozitës gjeografike të nënrajonit verilindor, shkaqet e larmisë natyrore, dukuritë fiziko gjeografike dhe pasuritë e shumta dhe të larmishme natyrore të këtij nënrajonit, diferencimin e tij në nënnyjësi përbërëse;
- të evidentojnë gjurmët e popullimit të hershëm të nënrajonit verilindor, veçoritë e këtij popullimi dhe të vendbanimeve, ndikimin e faktorëve natyrorë në popullimin dhe në ecurinë e treguesve të popullimit dhe të strukturës demografike;
- të shpjegojnë kushtet e zhvillimit ekonomik të nënrajonit verilindor dhe të nënnyjësisë përbërëse, ndikimin e faktorëve natyrorë, socialë e politikë në këtë zhvillim, nivelet e zhvillimit, strukturën e degëve të ekonomisë, zhvillimin e industrisë minerare, metalurgjisë me ngjyra dhe të hidroenergjisë dhe problemet e sotme të tyre; mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike, të turizmit etj.;
- të shpjegojnë kushtet natyrore të **Rajonit Juglindor**, veçoritë e pozitës gjeografike dhe të përparësive të saj, të relievit dhe të ofertave të tij për popullim dhe zhvillimin e bujqësisë; të dukurive klimatike, hidrografike, të tokave dhe botës së gjallë, problemeve mjedisore dhe të trashëgimisë natyrore dhe të pasurive në tërësi të rajonit;

- të evidentojnë gjurmët e popullimit të hershëm të Rajonit Juglindor, kushtet natyrore që ndikuan në këtë popullim dhe në shtimin e vazhdueshëm të dendësisë së popullimit; ecurinë e tij në shekullin e XX dhe shkaqet e shtimit të pakët; problemi i migrimeve të popullsisë; strukturën e popullsisë dhe ndryshimet e saj në kohë dhe sipas nënnjësive përbërëse; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë; veçoritë e vendbanimeve;
- të shpjegojnë kushtet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor dhe të nënnjësive përbërëse, ndikimin e faktorëve natyrorë, socialë e politikë në këtë zhvillim, nivelet e zhvillimit, strukturën e degëve të ekonomisë, zhvillimin e industrisë minerare dhe problemet e sotme të tyre; mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike, të turizmit etj.;
- të shpjegojnë kushtet natyrore të **Rajonit Jugor**; veçoritë dhe përparësitë e pozitës gjeografike; veçoritë mesdhetare të kushteve natyrore: relievit, klimës, hidrografisë, tokave dhe botës së gjallë, pasurive natyrore, problemeve mjedisore dhe të trashëgimisë natyrore;
- të evidentojnë gjurmët e popullimit të hershëm të Rajonit Jugor; kushtet natyrore që ndikuan në këtë popullim dhe në shtimin e vazhdueshëm të dendësisë së popullimit; shkaqet e shtimit të pakët në shekullin e fundit; problemi i migrimeve të popullsisë; strukturën e popullsisë dhe ndryshimet e saj në kohë dhe sipas nënnjësive përbërëse; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë; veçoritë e vendbanimeve;
- të shpjegojnë kushtet dhe veçoritë e zhvillimit ekonomik të rajonit dhe të aktiviteteve ekonomike; rajonet bujqësore dhe strukturën e prodhimit bujqësor, tendencat e zhvillimit ekonomik në të ardhmen; mundësitë e zhvillimit të turizmit;
- të shpjegojnë kushtet natyrore të **Rajonit Perëndimor**: prioritetet e pozitës gjeografike, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave për popullim dhe zhvillim social ekonomik, problemet mjedisore dhe trashëgimia natyrore e tij;
- të evidentojnë gjurmët e popullimit të hershëm të Rajonit Perëndimor: rolin e kushteve natyrore në këtë popullim, shkaqet e shtimit të shpejtë të popullsisë pas bonifikimeve dhe pas vitit '90; të përqendrimit të madh të popullsisë dhe vendbanimeve qytetare dhe rurale; të shpjegojnë pasojat e imigrimit të popullsisë në këtë rajon nga rajonet e tjera të vendit dhe pasojat në treguesit demografikë si: dendësi e përqindje e lartë e popullsisë qytetare, ndryshime në strukturën e popullsisë etj.; veçoritë e vendbanimeve;
- të shpjegojnë shkaqet dhe kushtet e zhvillimit të ekonomisë së rajonit në etapa të ndryshme, tendencat e zhvillimit të tij në kohën e sotme; strukturën e aktiviteteve ekonomike të

bujqësisë, industrisë, shërbimeve, transportit, turizmit dhe shkaqet e zhvillimeve të shpejta të tyre pas vitit '90;

- të ndërtojnë dhe të interpretojnë grafikët dhe hartat e popullsisë dhe të shpërndarjes gjeografike të aktiviteteve ekonomike në rajoneve të ndryshme të vendit.

## **VII. Trevat shqiptare përtej kufirit të Republikës së Shqipërisë**

Në përfundim të klasës së nëntë nxënësit do të jenë në gjendje:

- të shpjegojnë veçoritë e kushteve natyrore, të pasurive natyrore dhe të kushteve e faktorëve të popullimit dhe të zhvillimit social ekonomik;
- të shpjegojnë shkaqet e ecurisë së popullimit, të ndryshimeve strukturore të popullsisë dhe të përbërjes etnike të tyre, të përpjekjeve të bëra në të kaluarën nga regjimet e shteteve ku ato bëjnë pjesë për shpopullimin e këtyre trevave nga shqiptarët dhe popullimin e tyre me popullsi jo shqiptare, gjendja e statusit të tyre politik dhe e ardhmja e tyre në familjen e madhe evropiane;
- të evidentojnë problemet e shumta të zhvillimit të tyre social ekonomik dhe raportet e këtij zhvillimi me rajonet e tjera gjeografike të shtetit ku ato ndodhen;
- të përshkruajnë pozitën gjeografike të Kosovës, përparësitë e saj, kushtet natyrore dhe pasuritë e saj natyrore; trashëgiminë natyrore dhe problemet e saj;
- të shpjegojnë popullimin e lashtë të Kosovës nga ilirët të shqiptarët, kohën e ardhjes së sllavëve, përbërjen etnike dhe përpjekjet për ndryshimin e saj; migrimet e popullsisë dhe pasojat; statusi politik i Kosovës në periudha të ndryshme problemet e të drejtave të popullsisë shqiptare në periudha të ndryshme; shkaqet e luftës në Kosovë, ecuria e problemeve të Kosovës dhe zgjidhja përfundimtare e statusit të saj;
- të shpjegojnë veçoritë e qendrave të banuara, shpërndarjen gjeografike, vendosjen e tyre në raport me format e relievit dhe burimet natyrore, tiparet e qendrave rurale dhe urbane; shkallën e urbanizimit dhe tendencën e saj;
- të shpjegojnë veçoritë e zhvillimit ekonomik të Kosovës në periudha të ndryshme, të strukturës dhe shkaqet e zhvillimit të ngadalshëm; gjendja në kohën e sotme dhe perspektivat e tij;



- të tregojnë rajonet gjeografikë të Kosovës, shtrirjen dhe veçoritë e kushteve natyrore, të popullimit dhe zhvillimit ekonomik;
- të përcaktojnë shtrirjen e trevave shqiptare në Serbi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, statusin politik të tyre, veçoritë natyrore, të popullsisë, ekonomisë;
- të përcaktojnë shtrirjen e trevave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, veçoritë dhe përparësitë e pozitësgjeografike, të shtrirjes gjeografike, të tipareve fiziko-gjeografike dhe pasuritë natyrore, të statusit politik, të popullimit dhe të ecurisë, të përbërjes etnike, të ecurisë së strukturës së popullsisë, të tipareve të qendrave të banuara urbane dhe rurale; veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtyre trevave;
- të përshkruajnë shtrirjen dhe pozitëngjeografike të trevave shqiptare në Mal të Zi, statusin politik të tyre, tiparet fiziko-gjeografike dhe pasuritë natyrore, të popullimit dhe autoktonisë së popullsisë shqiptare, të numrit të popullsisë, strukturës dhe karakterit të migrimeve të popullsisë, të vendbanimeve rurale e urbane dhe veçoritë e zhvillimit të ekonomisë dhe të turizmit si degë kryesore e ekonomisë;
- të përshkruajnë shtrirjen dhe pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Greqi, veçoritë fiziko-gjeografike dhe pasuritë natyrore; popullimin dhe autoktoninë e popullsisë shqiptare; statusin politik të shqiptarëve në Greqi; veçoritë e popullsisë, qendrave të urbane e rurale dhe të përbërjes etnike të tyre; veçoritë e zhvillimit të ekonomisë;
- të lexojnë hartën e trevave shqiptare përtej kufirit, shtrirjen e objekteve kryesore fiziko-gjeografike, të qendrave kryesore të banuara, industriale dhe bujqësore.